



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa**  
**Izborni Panel za žalbe i Predstavke**

**A nr. 1180/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala, duke vendosur përkitazi me ankesat e Sebahate Qeriqi – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal (PDK) dega në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohen si të pabazuara ankesat:** Anr.1180, Anr.1181, të datës 03.12.2013, të Sebahate Qeriqi – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal (PDK) dega në Lipjan.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1180, Anr.1181, të datës 03.12.2013, të Sebahate Qeriqi – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal në Lipjan, në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave.

- Në ankesën Anr.1180/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 1326E është 01 votë, VV1326E janë 02 vota, prandaj konsideroj se unë jamë e dëmtuar pasi që votat e mija i janë dhënë kandidatëve të tjerë.
- Në ankesën Anr.1181/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se numëri i votave nga FRP në KQZ në QV1302E në fsh. Magure është 01, 02, 03, 04, 05, 06 vota.

Bazuar në nenin 6.3 të “*Rregullave dhe Procedurave*” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “*Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë*”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

## **Ankesat janë të pa bazuara**

Pretendimet ankimore nga ana e Sebahate Qeriqi – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhorë (KQZ), ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe munges të konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 1180/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



**Këshillë juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.